



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 406/1 prot.

Tiranë, më 27. 03. 2023

V E N D I M

Nr. 44, datë 27. 03. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 43 regj, datë 17.03.2023, të paraqitur nga subjekti ankues, Ll. Z., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a., në të cilën pretendohet diskriminim për çdo shkak tjetër¹.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, Ll. Z., në parashtrimet e paraqituara në ankesën e sjellë pranë KMD-së, informon ndër të tjera se, më datë 17.04.2020, pasi ka mbushur moshën për pension pleqërie, ka aplikuar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe ka marrë dijëni se masa e pensionit i është përlllogaritur për një periudhë prej 43 vite e 3 muaj.

Nga përlllogaritja e bërë prej tij, ka konstatuar se një periudhë prej 17 muajsh nuk figuronte si e paguar pranë sigurimeve shoqërore nga ana e ish punëdhënësit, Albpetrol sh.a. Referuar informacionit të marrë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ankuesi është vënë në dijëni se për periudhën 01.04.2013-30.03.2015, nga ish punëdhënësi Albpetrol sh.a., i janë paguar vetëm 7 muaj sigurime shoqërore, ndërkohë që duhet të ishin paguar rreth 2 vite në total.

Gjatë viteve 2014-2015, duke qenë se nuk i ishin paguar pagat nga punëdhësi, ankuesi thekson se i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar të drejtën e tij. Në këtë gjykim, sipas ankuesit, u konstatuan paligjshmëritë dhe mospagimi i pagave pa asnjë shkak ligjor nga ana e ish punëdhënësit. Për këtë, gjykata kishte vendosur detyrimin e Albpetrol-it, t'i paguajë ankuesit pagat mujore të munguara për periudhën 01.04.2013-30.03.2015.

¹ Si rezultat i zbatimit të pjesshëm të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Pas aplikimit për pension pleqërie në muajin Prill 2020, ankuesi ka konstatuar se nuk i ishin paguar nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a. 2 vite pune, për të cilat ishte shprehur gjykata. Në vijim, ankuesi i është drejtuar Shoqërisë Albpetrol sh.a., duke i kërkuar t'i paguheshin pagat e papaguara për periudhën e sipërcituar. Sipas tij, Shoqëria Albpetrol sh.a., i ka kthyer përgjigje, por në të nuk kuptohen qartë arsyet e problematikës së krijuar, lidhur me mospagesën e plotë të pagave.

Përsa më sipër, ankuesi thekson se ndihet i diskriminuar nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., për shkak se nuk kanë zbatuar të plotë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në përfundim, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese, si dhe të zbatohet i plotë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Ligji nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikohet: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Sa i përket pretendimeve të sipërcituara në ankesën e paraqitur, Komisioneri evidenton faktin se ankuesi i ka patur pjesë të shqyrtimit në kuadër të një ankese të mëparshme, me nr. 192 regj, datë 05.12.2022, për të cilën KMD është shprehur me vendimin Nr. 217, datë 12.12.2022.

Komisioneri vlerëson se, për të njëjtën çështje të bërë objekt shqyrtimi nga ankuesi nëpërmjet paraqitjes së kësaj ankese, është marrë një vendim i mëparshëm. Pra, nuk jemi në kushtet kur kemi të dhëna të reja, në mënyrë që të mundësohet marrja në shqyrtim e pretendimeve të bëra nga ankuesi në ankesën objekt shqyrtimi. Çështja e parashtruar që përbën objektin e kësaj ankese është e njëjtë me çështjen e marrë më parë në shqyrtim nga ana e Komisionerit dhe për të cilën është marrë një vendim i mëparshëm, ku është konstatuar se ankesa e Ll. Z., nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, pasi ishte paraqitur më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit dhe më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se përligjen kërkesat e nenit 33/4/c, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankësës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankësës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “c”³ të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi Ll. Z. kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a., nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

³ Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se: “4. **Ankesa nuk pranohet nëse:** a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; **c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;** ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankësës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/c dhe 10 të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, Ll. Z., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)